



Primar / Dërguar Punëjeto/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ / Njesira Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shërbime Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SHK	8609/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1069/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit. ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1069/2022 të datës 30.11.2022 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson kundër Vendimit me adresë banimi me Nr. Ref:591/2022 të datës 03.11.2022 dhe numër protokollit 4664 të datës 04.11.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1069/2022 të datës 30.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 30.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7497/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. Ref: 591/2022 të datës 03.11.2022 dhe numër protokollit 4664 të datës 04.11.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministria Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli me datën 13.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7497/2022 të datës 30.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me Nr. Ref:591/2022 të datës 03.11.2022 dhe

numër protokollli 4664 të datës 04.11.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref:024/13 të datës 25.01.2013; Vendimin me Nr.MPJ-ZSP188/14 i datës 02.12.2014; Vendimin me Nr.53/2015 të datës 19.06.2015; Vendimin me Nr.605/2019 i datës 08.08.2019; Vendimin me Nr.123/2020 i datës 30.03.2020; Vendimin me Nr.285/2020 i datës 30.06.2020; Vendimin me Nr.167/2020 i datës 24.09.2020; Vendimin me Nr. Ref:1047/2020 i datës 19.12.2020; Vendimin me Nr.ref:343/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.198/2020 i datës 13.05.2020; Akt Emërim i datës 05.12.2014; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2021 i datës 11.10.2021; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2019 i datës 23.10.2019; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2018 i datës 31.10.2018; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2017 i datës 30.10.2017; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2016 i datës 01.12.2016; Formular i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2015 i datës 17.11.2015; Autorizim i datës 21.11.2022 i përfaqësuesit Avokatit Përgjigjen në ankesë me numër protokollli 7957/2022 e datës 13.12.2022; Vendimin me Nr.ref:624/2020 i datës 27.08.2020; Kërkesë për aprovim i datës 26.11.2019 për shpallje të konkursit pozita: Asistent administrativ; E-maili i datës 26.11.2009 nga zyra e personelit MPJ; Raporti i datës 22.10.2009 për intervistën e kandidatëve për Asistent administrativ; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 26.11.2009; E-mail i datës 21.11.2012 nga për ; E-mail i datës 21.11.2012 nga për ; Shkresë e datë 21.11.2012 nga për aprovimin e kërkesës së Ambasadorit të Brukselit; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 26.11.2012; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.07.2012; Aplikacioni (CV) i ankueses, certifikatë e datës 03.08.2009; Certifikatë shëndetësore e datës 04.08.2009; Diplomë qershor 1993 lëshuar nga MASHT; Dëftesë e datës 10.06.1991, e qershorit 1992, e datës 20.06.1990, e majit 1993, reference e datës 01.09.2006 prej ½ faqe, Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 26.11.2009; Certifikatë e datës 29.10.2008.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, **nuk është kompetent**, për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1069/2022 të datës 30.11.2022, të parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës me Ambasadën e Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, sipas Kontratës së punës të datës 26.11.2009 me numër Nr.ref:MPJ-ZDP/A-006, me titullin e punës: "*Asistente administrativo*", në Ambasadën e Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, me kohë të caktuar deri me datë 26.11.2012, e nënshkruar nga Ambasador në Belgjikë, e cila kontratë është nxjerrë në bazë të nenin 19 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, dhe Raportit të datës 22.10.2009 me numër protokollli 2047, nga intervista e mbajtur me datë 13.10.2009.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesja me Vendimin Nr.Ref.024/13 të datës 25.01.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, duke i'u caktuar grada diplomatike "*Zëvendës Konsulle*", dhe njëkohësisht e njëjta caktohet të shërbej si Zëvendës Konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës-Bruksel. Bazuar në provat e lëndës rezulton së ankuesja me Vendimin Nr.MPJ-ZSP-188/14 të datës 02.12.2014 të Ministrit të MPJ-së është transferuar me rotacion, përkohësisht dhe caktohet në pozitë: "*Zyrtare e lartë për viza*", në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme tani e Diasporës, më pas ankueses i lëshohet Akt emërimi i datës 05.12.2014.



Tutje me Vendimin Nr.53/2015 të datës 19.06.2015 ankuesja me graden diplomatike Zëvendës Konsulle nga pozita "Zyrtare e lartë për viza", transferohet në lëvizje paralele në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin. Me Vendimin me Nr.405/2019 të datës 08.08.2019 të Ministrit të Punëve të Jashtme, ankuesja me gradën Zëvendës Konsulle, caktohet në Misionin Diplomatik të Republikës së Kosovës në Berlin/Gjermani, i zgjatet mandati i qëndrimit në këtë misionin deri me datës 30.07.2020, ndërsa me Vendimin me Nr.123/2020 të datës 30.03.2020 të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesja është tërheq nga misioni më datë 30.06.2020, për shkak se nuk i është nënshtruar procedurave të pranimit në shërbimin e jashtëm të përcaktuara me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, dhe proceduarve dhe rregullave të përcaktuara në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës, me anë të cilit vendim janë përfunduar të gjitha obligimet ligjor dhe financiare.

Me Vendimin me Nr. Ref: 624/2020 të datës 27.08.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e shfuqizon Vendimin me Nr.123/2020 të datës 30.03.2020, dhe ankuesen e kthen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për nevoja të ministrisë, ndërsa sipas Vendimit me Nr.167/2020 të datës 24.09.2020 Zv. Sekretari i Përgjithshëm, ankuesen e sistemon në pozitë "Zyrtare e lartë për trajnime-Akademine Diplomatike", në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë, duke filluar nga data 01.09.2020,

Nga provat e lëndës rrjedhe se me Vendimin me Nr.Ref:1047/2020 të datës 19.12.2020 ankuesja me gradën Zëvendës Konsulle caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Mbretërinë e Belgjikës, me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.03.2021.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 03.11.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:591/2022 përmes të cilit ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr.Ref: 024/13 të datës 25.01.2013 për emërimin e ankueses si anëtare e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, Vendimi me Nr. Ref: 624/2020 i datës 27.08.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Vendimi me Nr.167/2020 i datës 24.09.2020, lidhur me caktimin e ankueses në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Mbretërinë e Belgjikës, mbi bazën se ankuesja është emëruar në shërbim të jashtëm në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Ref: 591/2022 të datës 03.11.2022 dhe numër protokolli 4664 të datës 04.11.2022 të Ministres së MPJD-së, pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkeljeve të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet se: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarve politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në*



Ministrinë e Punëve të Jashtme, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore si dhe duke marrë për bazë faktin se ankuesja në shërbimin e jashtëm ishte rekrutuar si staf vendor në Ambasadën e Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, respektivisht Kontratës së punës të lëshuar me datë 26.11.2009 me numër Nr.ref:MPJ-ZDP/A-006, në vendin e punës "Asistente administrative", në Ambasadën e Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, me kohë të caktuar deri me datë 26.11.2012, e në fakt, personeli administrativ, teknik dhe shërbyes, dhe personeli vendor në baze të nenit 19 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm përsoshen për të mbështetur veprimtarinë e misionit diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës gjegjësisht për kryerjen e punëve administrative, teknike dhe shërbyese dhe për realizimin e të drejtave të tyre personeli vendor i nënshtrohet legjislacionit të shtetit pranues, andaj këto kategori të punësuarve nuk janë anëtarë me karrierë të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës. Po ashtu duke marrë parasysh faktin se ankuesja në vitin 2013 ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e me asnjë provë nuk vërtetohet se e njëjta ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil, përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se **Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil**, lidhur me këtë konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1069/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Proçesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.